

VENDIM
Nr. 195, datë 30.8.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “DERBI-E” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “ANTENA”, ME FUQI TË
INSTALUAR 1105 kw**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përparitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “Derbi-E” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Antena”, me vendndodhje në lumin e Zallit të Shtamës, Bashkia Mat, qarku Dibër, me fuqi të instaluar 1105 kw,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 167, datë 19.7.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Derbi-E” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Antena”, me fuqi të instaluar 1105 kw.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE me shkresën nr. 55/52 prot., datë 24.7.2018, ka kryer njoftimin në median e shkruar dhe me shkresën nr. 503/1 prot., datë 31.7.2018, ka përcjellë pranë subjektit kërkesën për plotësim të dokumentacionit të munguar, kërkesë e cila është përsëritur me shkresën nr. 503/3 prot., datë 16.8.2018.

- Në vijim të sa më sipër, subjekti “Derbi-E” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 503/4 prot., datë 27.8.2018, ka përcjellë në ERE gjithë dokumentacionin e munguar të sipërcituar.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Derbi-E” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “Derbi-E” sh.p.k., mbështetur në pikën 2, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar, ka aplikuar në MEI dhe ka marrë miratimin përfundimtar nr. 5184/1 prot., datë 20.7.2017, për ndërtimin e HEC-it “Antena”, me kapacitet 1105 kw.

- MEI, pas miratimit përfundimtar nr. 5184/1 prot., datë 20.7.2017, ka lidhur me mbajtësin e miratimit përfundimtar shoqërinë “Derbi-E” sh.p.k., kontratën nr. 1859 rep., nr. 833/2 kol., datë 7.8.2017, sipërcituar.

- Subjekti ka paraqitur në ERE, me shkresën e protokolluar me tonën nr. 503/4, datë 27.8.2018, kontratën e qirasë, datë 8.5.2017, të lidhur midis Bashkisë Mat, me cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Derbi-E” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, të amenduar referuar shkresës së Bashkisë Mat nr. 121 prot., datë 16.1.2018 (amendimi nr. 1 i kontratës së qirasë datë 8.5.2017 me shoqërinë “Derbi-E”, ku neni 3 i kontratës i lidhur për afatin 1-vjeçar bëhet për një periudhë 5-vjeçare me të drejtë përsëritjeje). Palët kanë nënshkruar për dhënien me qira të fondit pyjor kullosor publik, me sipërfaqe 5.921 km (hapje kanalesh, shtrirje tubacionesh, ndërtim rruge, ndërtim linje tensioni 10 kV, për ndërtimin e HEC-it “Antena”, vetëm sipas qëllimit, gjatësive dhe sipërfaqeve të miratuara nga Bashkia Mat, për

ushtrimin e veprimtarisë dhe kërkesave të përcaktuara në kontratë dhe leje mjedisore.

- OSHEE-ja, me shkresën nr. 29784/1 prot., datë 11.12.2019, ka miratuar lejen për lidhjen e HEC-it “Antena” në rrjetin elektrik të shpërndarjes.

- Subjekti “Derbi-E” sh.p.k. ka marrë miratimin përfundimtar nga MIE për një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër, ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

- Aplikimi i shoqërisë “Derbi-E” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1): plotësuar.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2): plotësuar.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3): plotësuar.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5): plotësuar.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Derbi-E” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Antena”, me fuqi 1105 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “Derbi -E” sh.p.k. në përfundim të afati 5-vjeçar të kontratës së qirasë me Bashkinë Mat, të depozitojë në ERE kontratën e rifreskuar.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti